ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220-24-13287-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **"Furnizim me Reagjent dhe materail shpenzues per Laborator sipas Loteve te ndara" (LOT 4)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Sentimed Sh.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ali Vitija, Model Sllovenia, LLamella A/1
Prishtinë — **10000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*
+383 (0)49 214 668 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Nel Kuqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
support@sentimed-ks.com
(Adresa elektronike)

21.05.2025 — _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA SENTIMED 811499783 PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ — _____
(Numri i Telefonit) — *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Dosja e Tenderit me nr. prokurimi 220-24-13287-1-1-1 st. 17.12.2024 LOt 4

B12 Procesverbali i Hapjes date 08.04.2025
B 58 Njoftimi mbi vendimin e AK te dates 05.05.2025
Kerkesa per Risahqyrtim date 08.05.2025
Vendimi per refuzimin e kerkeses per rishqyrtim date 12.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [X]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim: 08.05.2025
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 12.05.2025

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 66 par.2 LPP
Neni 25 par. 15 të RRPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

HYRJE

Autoriteti kontraktues (AK) ka shkelur nenin 66 par. 2 të LPP lidhur me nenin 25 par. 15 të RRPP

Operatori Ekonomik SENTIMED SH.P.K, duke iu referuar vendimit te AK për diskualifikimin tonë në procedurën e prokurimit të lartpërmendur, shprehim pakënaqësinë dhe kundërshtimin tonë lidhur me arsyetimin që është dhënë konkretisht se "autorizimi i ofruar ka qenë i përgjithshëm dhe jo i specifikuar për tenderin përkatës".
Ju informojmë se ne kemi paraqitur një autorizim të vlefshëm dhe specifik, të lëshuar nga vetë prodhuësi SNIBE , Shenzhen New Industries Biomedical Engineering Co., Ltd, me të cilin:

Autorizohemi për tregtim, mirëmbajtje dhe pjesëmarrje në tenderë në territorin e Kosovës

Janë të përfshira produktet konkrete të përmendura në tender:

Sistemet e analizës Maglumi (Immunoassay)

Sistemet Bioassay (Clinical Biochemistry)

Reagensat, pjesët këmbimore dhe konsumablat për këto pajisje

Autorizimi është i personalizuar për kompaninë tonë (SENTIMED SH.P.K), duke përfshirë adresën dhe afatin e vlefshmërisë (deri më 31 dhjetor 2025).

Në përputhje me dokumentacionin e tenderit (p.sh. neni 9.1 dhe kërkesat për LOT 1 dhe LOT 4), ku theksohet se "Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë me autorizim nga prodhuesi ose distributori për shitjen e reagensave për këtë aktivitet të prokurimit", autorizimi ynë i përmbush në tërësi këtë kërkesë.

Interpretimi që ky dokument është i përgjithshëm është i pabazuar, pasi në të:

Përmenden pajisjet dhe produktet konkrete për të cilat kërkohet furnizimi;

Përcaktohet territori i aplikimit (Kosovë);

Emërtohet qartë autorizimi për pjesëmarrje në tenderë në territorin e Kosovës.

AK nuk ka perfshire ne dosjen e tenderit shabllonin per Autorizimin nga Prodhuesi, te cilen do te mund ta perfshinte sipas RRPP neni 44 par.4, per sa kohe shablloni nuk eshte i specifikuar, rrjedhimisht kompania prodhuese e ka derguar autorizimin sipas formatit te saj e cila nuk e perjashton specifikisht kete tender.

AK ka vepruar ne kundershtim me kriteret e dhenies se kontrates ku ceket qe do te shperblehet oferta me e ulet, dhe ka shperblyer me kontrate nje OE i cili e demton buxhetin e shtetit me 12.908 eur .

Sa i përket pretendimit tone, realisht AK nuk ka trajtuar aspak seriozisht këto pretendimin por vetëm ka thënë që Autorizimi i ofruar ka qene i pergjithshem dhe ka shperblyer me kontrate nje OE me oferte me t elarte , duke demtuar buxhetin e shtetit.

Nga sa u tha më sipër, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET ankesa e parashtruar nga OE "Sentimed SHPK" ashtu që aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM** .

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të caktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*